

popullore. Kjo barrë ra sidomos edhe mbi Institutin e Kulturës Popullore. Organizuese e Festivalit ishte Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sporteve, kurse bartëse e organizimeve Qendra Foklorike Kombëtare dhe drejtori i saj, Ermir Dizdari. Kosova mori pjesë me ftesë të kësaj ministrie. Departamenti i Kulturës i Kosovës ia besoi përzgjedhjen Institutit Albanologjik të Prishtinës. Në grupin përzgjedhës të teksteve, të veshjeve, të valleve dhe të këngëve popullore ishin dr. Zymer Neziri, dr. Ukë Xhemaj e Bahtir Sheholli.

Me artistët popullorë ishte edhe dr. Sadri Fetiu, drejtor i IAP-it.

Festivali Foklorik Kombëtar ishte ngjarje e madhe etnokulturore e Ballkanit dhe me peshë të veçantë në mozaikun etnokulturor të Mesdheut dhe të Evropës.

Zymer NEZIRI

### **Në Degën e Etnologjisë u mbrojt disertacioni i parë i doktoratës**

Në Degën e Etnologjisë të Institutit Albanologjik të Prishtinës u mbrojt disertacioni i parë i doktoratës në fushën e shkencës së etnologjisë, nga kandidati mr. Ukë Xhemaj, hulumtues i pavarur i kësaj dege të IAP-it. Disertacionin e doktoratës, me titull *Podguri-etnokultura shqiptare në kontinuitetin historik*, e mbrojt më 9.9.1999, para Komisionit: akademik prof. dr. Mark Krasniqi, dr. Drita Statovci, këshilltare shkencore, dr. Rexhep Munishi, këshilltar shkencor.

Ky disertacion i doktoratës i kandidatit mr. Ukë Xhemaj u vlerësua lart nga komisioni. Ai është një monografi e mirëfilltë shkencore etnologjike, ku përfshihet hapësira, jeta dhe kultura shqiptare e kësaj krahine në rrethin e Pejës. Qasja serioze, këmbëngulësia për t'u argumentuar secila tezë e hipotezë e shtruar në këtë punim, duket se ishte synimi parësor i kandidatit, thuhet në vlerësimin e komisionit. Ky është një kontribut me rëndësi për etnologjinë dhe për studimet albanologjike.

Zymer NEZIRI